



## PROCESVERBAL IX/2023

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 8 (tetë) të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi: Suharekë  
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës  
Data: 28.09.2023  
Ora: 10.00

---

### Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyçi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevxhet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Znj.Saranda

Bajraktari

Znj.Mimoza Bajraktari

Znj.Festë Kabashi

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Z.Herolind Limaj

Znj.Jehona Rrafshi

### Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj.Habibe Bytyqi

Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi.

**Kryesuesi** - përshëndet të pranishmit dhe kërkon nga të pranishmit që ta nderojmë heroin e Kombit-rreshterin Afrim Bunjaku me një minutë heshtje.

**Kryesuesi** - ju informoj që pikën e tretë do ta tërheqim nga rendi i ditës për arsye se vendimin i cili është marrë me date 28.07.2023 është miratu plotësisht dhe është i plotëfuqishëm.

Tani po ju njoftoj me rendin e ditës.

### ***REND DITE***

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2024;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani” me seli në Suharekë;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343 të datës 28.01.2022;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 i datës 29.01.2021;**
- 6. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e ZKA-së;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës pa pikën 3.

**Unanimisht Miratohet rendi i ditës.**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - i hedh në votim dy procesverbalet.

**Unanimisht Miratohet pika 1.**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2024;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - kur jemi te projekt-vendimi për mirarimin e buxhetit,unë sot ndryshe nga herave tjera detyrohem që fjalën time ta filloj me zhvillimet e fundit në Komunën tonë për faktin se është pikërisht keqplanifikimi dhe keqmenaxhimi i buxhetit që lidhet me këto zhvillime.Arrestimet e fundit të Drejtorit Komunal për fat të keq nuk janë thjesht një rast i izoluar i shkeljeve ligjore.Kjo nuk është thjesht një gabim që këta zyrtarë e kanë bërë,kjo është formulë qeverisëse që ju keni instaluar këto vitet e fundit në Komunën tonë.Prandaj përgjegjësia nuk është vetëm e zyrtarëve të arrestuar,ata janë fajtor vetëm për pjesën që kanë dëgjuar urdhërat e Kryetarit sepse probleme të tilla janë në shumicën e kontratave që ju keni hartuar e implementuar ndër vite.Kryetari nuk mund të sillet sikur asgjë nuk ka ndodhur por duhet ti marrë përgjegjësitë që i takojnë sepse përgjegjësia kryesore është e tij.Pranda Kryetari duhet të dorëhiqet

dhe ti jep mundësi drejtësisë të zbardhë secilin vendim të kundërligjshëm që ka marrë gjatë gjithë kësaj kohe. Të nderuar kuvendarë, situata është tepër serioze dhe ju e dini këtë, shkeljet janë të mëdha dhe ju e dini këtë, shkeljet janë të qëllimshme dhe ju e dini këtë. Me këtë rast dua të iu rikujtoj se të gjithë ne kuvendarët e të gjitha partive në sallë, nuk jemi thjesht anëtarët e një subjekti, jemi më shumë se kaq. Të gjithë ne kemi marrë besimin qytetarë dhe në seancën tonë të parë kemi dhënë betimin që do të punojmë sipas ligjit dhe në interes për gjithë qytetarë. Prandaj ju ftoj që të marrim përgjegjësitë që na takojnë sipas ligjit e sipas betimit që kemi dhënë. Është koha e fundit që ta ndalojmë këtë formulë qeverisëse, është koha ti themi jo këtij keqplanifikimi se nëse miratohet ky buxhet kështu siq është sjell në Kuvend, kjo do të hapte rrugë për shkelje tjera ligjore në vitin e ardhshëm. Rreth kornizës buxhetore 2024-2026 dua të ju rikurtoj se nën organizimin e OSBE-së është mbajtur një takim paraprak me anëtarët e KPF-së në të cilin takim kam ngritur shqetësimet e mia për këtë dokument. Por përkundër kësaj ky pushtet nuk ka ndryshuar pothuaj asgjë nga drafti i parë dhe e ka sjell tek ne me gabimet e njejeta. Kjo tregon papërgjegjësinë e këtij pushteti, se ky dokument është jo serioz dhe nuk duhet të votohet. Shihet nga fakti se në disa vendbanime nuk janë përcaktuar investimet që do të bëhen për secilin vit veq e veq. Paramendoni, në këtë dokument për fshatin Krushicë e Poshtme, për tri vitet e ardhshme janë planifikuar vetëm 5.000€ edhe pse sipas banorëve atje ka ende nevoja për investime në rrugë e investime tjera. Në fshatin Sllapuzhan për tri vitet e ardhshme është planifiku të shtrohet vetëm rruga tek varrezat-vazhdim. Në Bllacë si duket problemet do të vazhdojnë edhe më shumë sepse sipas këtij planifikimi përveq disa rrugicave nuk po vërehet që ka ndonjë investim tjetër, ndërsa atje vazhdojnë me qenë të mëdha problemet me kanalizime, me ndriçim, hapësira publike, problemet e varrezave. Problemet me ujëra të zeza janë serioze në Bllacë. Lidhur me këtë unë edhe vitin e kaluar kam ngritur nevojën e ndërtimit të një impianti të ujërave të zeza atje por ju as atëherë e as tani nuk e keni trajtuar planifikim e këtij problemi në fshatin Bllacë. Gjithëashtu shtarati i lumit është i mbushur me ujëra të zeza dhe kundërmon dhe përkundër kërkesave të mia që të rregullohet shtarti i lumit në Bllacë, në këtë buxhet nuk është planifikuar diçka e tillë. Ura në këtë fshat ende vazhdon të jetë pa rrethoja dhe kjo paraqet rrezik për fëmijët që kalojnë në atë rrugë. Është edhe më i çudishëm e i pranueshëm fakti se në këtë buxhet janë planifiku të shtrohen edhe rrugë që janë të shtruara apo rrugë që janë të planifikuara të shtrohen gjatë viti 2023. Në fshatin Budakovë janë planifiku të shtrohen rrugët “Mehmet Xhafa dhe Bjeshka e Budakovës” por këto rrugë janë të planifikuara edhe në vitin 2023. Këto rrugë, a do të shtrohen në vitin 2023 apo në vitin 2024? Në fshatin Doberdelan janë planifikuar të shtrohen rrugët “Aziz Limani e Sejdi Fejza” mirëpo këto dy rrugë figurojnë edhe në vitin 2023. Edhe më e çuditshme është sepse këto rrugë janë rrugë të oborreve ndërsa rruga “Metush Krasniqi” që lidh fshatin Doberdelan me Samadraxhën edhe pse është kërkesë e banorëve, nuk është planifikuar fare as për tri vitete e ardhshme. Në Luzhnicë, për tri vitete e ardhshme janë planifiku 45.000€ për ndërtimin e rrugëve, vazhdim i seg. “Tahir Sinani dhe Afrim Buqa” por e vërteta është që gjatë këtij viti, atje është shtruar një rrugë që nuk është planifikuar fare. Në fshatin Greiqec ju keni planifiku vazhdimin e rrugës “Seferi” por po harroni që as që e keni fillu këtë rrugë edhe pse e keni në planifikim të vitit 2023. Poashtu për këtë fshat janë planifiku edhe rrugët “8 vëllezërit” por kjo rrugë është kontraktuar nga ju në vitin 2022 por ende nuk është shtruar. A mund të më tregoni pse nuk janë shtruar rrugët “Hajriz Xhema, Esat Qarri” ku dihet fakti që ju keni hartu kontratë për ti shtruar këto rrugë vite më parë. Në Suharekë është planifikuar të ndërtohet rruga “Nënë Tereza” në vitin 2025 mirëpo e vërteta është që kjo rrugë është e shtruar. Njëjtë është edhe planifikimi i rrugës “Milit Kryeziu” por kjo rrugë është e shtruar ndërsa rruga “Bubulina” e rrugë të tjera, edhe pse nuk janë të shtruara nuk figurojnë në planifikimin që keni bërë edhe për tri vitet e ardhshme. Në këtë dokument janë planifikuar 345.000€ për ndërtimin e aneksit të objektit të shkollës “Besim Ndreca” në Maqitevë mirëpo e vërteta është që për këtë aneks në buxhetin e vitit 2023 janë planifikuar 120.000€ dhe ende nuk keni bërë asgjë. Ky aneks a do të ndërtohet në vitin 2023 ku janë të planifikuara 120.000€ apo do të bëhet në tri vitet e ardhshme ku i keni planifiku 345.000€. Rezulton që për këtë projekt keni planifiku 465.000€. Këto mjete, edhe nëse ndërtojmë shkollë të re, besoj do të jenë shumë e leje më për një aneks dhe duke e ditë faktin që numri i nxënësve në vazhdimësi është në rënie. Të dashur kuvendar, qytetarë, shqetësimet që ngrita janë vetëm disa nga shumë probleme që ky buxhet ka, andaj si i tillë nuk duhet të kaloj. Andaj ju ftoj secilin prej jush që të mos e votojmë këtë buxhet në këtë

formë. Vota juaj kundër do ti jepte mundësi ndryshimit të këtij planifikimi dhe rrjedhimisht do të mbronte interesin qytetar.

**Doruntina Zenelaj** - në këtë planifikim që keni sjell, për fshatin Savrovë është planifikuar rruga “UÇK, Ukë Ndreca dhe Sinan Aliaj” mirëpo e vërteta është se rruga “UÇK” është në planifikim të vitit 2023. Kjo rrugë a do të shtrohet në vitin 2023 apo do të mbetet për vitin 2024 siq e keni sjell tani? Ndërsa rrugën “Ukë Ndreca” ju e keni planifikuar për vitin 2024 por e vërteta është se kjo rrugë ka qenë e planifikuar në vitin 2022 dhe nuk është shtruar. Pse nuk është shtruar kjo rrugë sipas planifikimit të vitit 2022? Rruga “Sinan Aliaj” figuron në planifikim për tu shtruar në vitin 2024, unë e kam vizituar këtë rrugë dhe kjo rrugë është e shtruar këtë vit. Kjo është e papranueshme.

**Selman Kolgeci** - kjo shpërndarje e buxhetit në investime për vitin 2024 konsideroj që duhet me iu nënshtruar shumë plotësimeve e ndryshimeve në mënyrë që buxheti të jetë për qytetarët e ndarja buxhetore të jetë e zbatueshme e jo të haset në vështirësi siq kemi pasur deri më tani. Sa i përket plotësimeve, e kam përsëritur disa herë që banorët e fshatit Vraniq e kanë prioritet furnizimin me ujë të pijes, funksionalizimin e varrezave të reja sipas vendimit të Asamblesë, përfundimin e kanalizimit në pjesë të cilat nuk janë të lidhura në këtë rrjet e shumë projekte tjera. Këto projekte duhet të jenë projeksione buxhetore për vitin 2024. Plotësim tjetër për këtë projekt-buxhet është edhe një makineri për pastrimin e rrugëve, një auto fshisë. Të gjithë e dimë për sfidat që po i kalon Eko Regjioni dhe për ti dalë ndihmë kësaj ndërmarrje, Komuna duhet të siguroj një autofshisë e cila do ti lironte së paku 5-6 punëtorë që të merreshin me aktivitete tjera brenda ndërmarrjes dhe pastrimi i qytetit të bëhet me një person të vetëm në një kohë shumë më të shpejtë dhe shumë më shpesh se sa tani. Ndërsa që ndarja buxhetore të jetë e zbatueshme duhet të dimë disa fakte: Çka keni menduar të investoni në rrugën “Udha e shkronjave” në Vraniq ku i keni planifikuar 60.000€ për atë rrugë por ajo rrugë është e asfaltuar dhe është në gjendje të mirë? Çështje tjetër është asfaltimi i rrugës në beshkët e Vraniqit. A po bëhet fjalë për rrugën të cilën e keni tenderuar, kontraktuar dhe është paguar tre herë, tash keni vendosur veq me ia ndërruar emrin? Projekte tjera të parapara për vitin 2024 por që rrezikojnë të mos zbatohen janë edhe ndërtimi i impianteve për ujëra të zeza në Dubravë dhe në Sllapuzhan. As nuk keni gjetur lokacion, as nuk keni studim të fizibilitetit, as nuk keni mbajtur diskutime publike me qytetarët, as nuk keni hartuar projekte e paramasa dhe në paramasën për hartimin e projekteve që e keni afër nënshkrimit nuk ekziston asnjë pozicion ku keni paraparë që duhet të hartohet projekt detal për impiantet për pastrimin e ujërave të zeza. Krejt çka keni bërë në këto dy projekte është se e keni kopjuar nga programi jonë zgjedhor. Temë tjetër është mos planifikimi buxhetor për hartimin e projekteve për vitin 2024. Kjo po ndikon që projektet të realizohen duke mos respektuar asnjë standart apo normë teknike ndërtimore. Ne e kemi ngritur këtë çështje shumë herë por nuk e kam të qartë se pse po vazhdoni në këtë formë kur e dini që jeni duke e dëmtuar secilin projekt, si në cilësi, si në funksion e si në sasi. Për të njejtën gjë, ju i jeni përgjigjur auditorit të përgjithshëm në planin e veprimit që keni me ndërmarrë hapa për me hartuar projekte. Tash në projektin buxhetor nuk e keni hartimin e projekteve apo thjesht jeni zotë sa për me kaluar si procedurë. Secila rrugë dhe secili objekt i ka specifikat e veta që dallojnë prej projekteve tjera. Mbi çfarë baze, mbi çfarë reference po i nxjerrni vlerën e investimit? Kjo, as metoda e tahminit nuk është.

**Liridon Fandaj** - nëse ia hedhim një sy dëgjimeve publike të organizuara nga ekzekutivi i Komunës së Therandës për buxhetin e vitit 2024, në ato dëgjime publike ka pasur shumë zyrtar komunal sesa qytetarë. Edhe pak ata qytetarë që kanë marrë pjesë aty, propozimet dhe projekt-propozimet e tyre nuk janë marrë parasysh, andaj ky buxhet i sjellur nuk përmbush as kërkesat elementare qytetare. Këtë buxhet do ta quaja një fontanë dëshirash pa balancë e pa vizion. Ka mungesë të politikave që rregullojnë mirëqenien e qytetarëve. Po ashtu kryetar, vetëm bizneset e afërta me ju janë në gjithëpërfshirje pasi në këtë buxhet më shumë kemi asfalt dhe kubëza. Nëse dalim te investimet kapitale të planifikuara në këtë buxhet dhe vlera totale është 6,222,230.00. Nëse e marrim si total të buxhetit të përgjithshëm atëherë i bie që 27.26 % të buxhetit total janë të ndara për investime kapitale. Nëse këtë vlerë e ndajmë në përqindje në drejtori atëherë do të ishte kështu: Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë 62.75 % -drejtoria e kubëzave dhe asfaltit; Drejtoria për Buxhet dhe Financa 1.16% -ndërtimi i shtigjeve të ecjes nga Budakova Vraniqi deri në Greikoc, huqje totale drejtor; Drejtoria e Administratës dhe Personelit 0.16% -ndërtimi i objektit të K. Komunal në Suharekë 10.000. Nuk ndërtohet objekti me 10.000 € pa lokacion dhe pa projekt;

Drejtoria e Urbanizmit 1.99% të buxhetit për investime kapitale-ndërtimi i pullazeve dhe izolimit të objekteve kolektive në Suharekë 40.000.Ku janë këto objekte dhe cilat ke planifiku me i izolu?Ndërtimi i zonave smart 80.000€.Ku janë ato zona dhe a ka mundësi me tregu se çka nënkupton me zona smart? Drejtoria e Bujqësisë,nuk po kuptoj a jeni drejtor për bujqësi ku përfshierja është 8.96 % e buxhetit për investime kapitale ndërsa në drejtorinë tënde ke asfalt me shtru nëpër malet e Vraniqit.Drejtoria e Kulturës në totalin e buxhetit për investimeve kapitale 6.64%.Si ka mundësi të planifikohet buxhet për shtëpinë e kultures ku ende s'keni fillu me ndërtimin për buxhetin e ndarë për vitin 2023 apo keni planifiku me rrënu shkollën në mbrojtje të ministrisë.Edhe kjo një huqje totale, ndarje e buxhetit pa lokacion dhe pa plan; Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale 5.14% e buxhetit të investimeve kapitale.Për shëndetësi shpresojmë që planifikimi të jetë i duhur te aparatura dhe t'ju shërbej qytetarëve e mos të rrijë në sirtar pa u hapur fare siq janë disa në QKMF; Drejtoria për Arsim 13.16%-ndërtimi i aneksit në Maqitevë 200.000€.A ka fillu ky aneks sepse në vitin 2023 janë planifikuar 120.000€ dhe a është i nevojshëm ky aneks pasi që numri i nxënësve çdo vit është në rënie?; Drejtoria e Pronës dhe Katastrës ka 0% të investimeve kapitale.Drejtor,Kryetari nuk të ka besu për asnjë projekt dhe projektin për paisjet gjeodezike ia ka dërgu shërbimeve publike pasi që tash e mbas së bashku me ty do t'i nënshkruani projektet e famshme të shërbimeve publike.Po t'i analizosh këto investime kapitale të planifikuara nëpër fshatra nga Drejtoria e Shërbimeve Publike na del që disa rrugë janë të ndërtuara nëpër vite dhe nuk janë projekte dy vjeqare apo siq jemi mësuar ti dëgjojmë segmente të mbetura të papërfunduara ose të planifikuara për 2023.Nuk e di si ke guxim që pas ngjarjeve të fundit të ndodhura në kabinetin tënd dhe arrestimet e zyrtarëve,ti po vazhdon me avazin e vjetër dhe atë thënien e famshme:Kryetari merr vendime,nuk shkon në burg dhe kush nënshkruan e baftë me shëndet. Kjo të pret Drejtor i Katastrës dhe Pronës pasi që je tash në komisionin për nënshkrimin e kontratave.Edhe një herë them se ky buxhet nuk përfaqëson kërkesat e qytetarëve dhe si të tillë nuk do ta përkrahim.

**Shefket Kolgeci** - po mos të ishin disa salla sportive,90% e projekt-buxhetit për vitin e ardhshëm janë rrugë.Kryetar,unë e shoh një paaftësi të qeverisë tuaj,gjithë zyrtarëve,edhe drejtorave dhe personelit,që nuk kanë dalë në teren.Unë mendoj që ky buxhet u bë pa dal në teren,me vlerësu gjendjen cila është ma e nevojshme.Unë nisem nga fshati im ku ende e kemi të pa kryer kanalizimin në shumë lagje.Është dasht të paktën me u konsultu me kryesinë e fshatit por edhe me ne si asambleist që së pari të kryhen ato pjesë të kanalizimit që kanë mbet pa u kryer por edhe ato që janë kry, nuk po funksionojnë.Prandaj,kjo është mungesa dhe paaftësia e qeverisë tuaj. Kanalizime nuk ka gati në tërë projekt buxhetin.Kryetar ky buxhet vërtetë është i varfër,i pa planifikuar si duhet.Nuk je konsultu me komunitetin se çfarë prioriteti kanë ata.Prandaj edhe unë apeloj që të mos votohet shkaku që nuk po përfitojnë qytetarët por grupe të caktuara.Përpara në Asamble ka qenë një rregullore,një parim,që kur vjen buxheti për vitin tjetër,Kryetari mi thirrë shefat e grupeve parlamentare ku secili grup i ka kërkesat e veta.Mi harmonizu ato dhe pastaj kur të kishim ardhë këtu,do ta kishim votu.Pse?sepse interesat e qytetarëve i kishim harmonizu më mirë dhe do të kishim votu.Rrugën “Dy Rrahët” tani e ke fut në plan dhe pa u vendos mur mbrojtës aty nuk bëhet ajo rrugë.Pra Kryetar,herave tjera të preferoj që mu konsultu edhe me opozitën sepse opozita ka rëndësi të madhe në demokraci.

**Flamur Bytyçi** - në parim vota ime është kundër për shkak se nuk po shoh zhvillim në këtë projekt-buxhet.P.sh. njërën prej pikave që e pash është te projektet kapitale dhe që tri vite përsëritet ndërtimi i Kolektorit dhe s'po kuptoj pse nuk po fillojnë punimet.Gjithëashtu është planifiku ndërtimi i rrugëve lokale dhe janë nda 1.000.000€.Nuk ka specifik se ku kanë me u ndërtu këto rrugë.Kjo është pasqyra e juaj si pushtet që punoni pa projekte dhe pa zhvillim të Komunës tonë.Gjithëashtu është ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunë,vlera e planifikuar 1.200.000€ për dy vite.Gjatë këtij viti unë kam kërku qasje në dokumente zyrtare mirëpo për shkak të kokëfortësisë më është refuzu qasja dhe vetëm pas vendimit që e ka lëshu agjensioni për informacion dhe privatësi,dokumentet më janë dorëzuar.Bëhet fjalë për ndërtimin dhe sanimin e kanalizimeve në Bllacë,Samadraxhë dhe Suharekë ku për çudi pagesat janë bërë dhe realiteti qëndron ndryshe.Mbikqyrësi dhe menaxheri i kontratës e ndryshojnë vetëm shumën ndërsa harrojnë me ndryshu numrin e faturës.Pse nuk keni mendu me bo një sallë sportive në Semetishtë dhe pse nuk e keni fut edhe për funksionalizimin e ujësjellësit në fshatin Peqan?

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

**14 për, 13 kundër  
Miratohet pika 2**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343 të datës 28.01.2022;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Flamur Bytyçi** - dua ta pyes drejtorin e Arsimit se pse po bëhet ky ndërrim?

**Remzi Bajselmani** - është procedurë në gjithë Kosovën dhe është bërë rizgjedhja e këshillave të prindërve me udhëzimin administrativ 01-2023.Sa i përket që ka ardhë në Asamblenë Komunale, DKA nuk është sponsorizues i kësaj pike,as s'ë kemi kërku dhe as nuk kërkohet me udhëzim administrativ dhe s'ka të bëjë me DKA.

**Flamur Bytyçi** - nuk po kuptoj,pse duhet me hedh në votim ne? Pse me votu një diçka që s'pe kuptojmë ne ?

**Liridon Fandaj** - a jeni në koordinim a pa koordinim?Si është puna e kësaj pike?Drejtori i Arsimit thotë që nuk është e sponsorume.Nga ka ardhë kjo pikë?A keni sjell ti dhe Kryetari?Edhe në KPF kam kërku një material rreth zgjedhjes së saj.Nuk kam asgjë kundra saj por a ka ndonjë procesverbal dhe nga cilët anëtar të këshillave të prindërve u zgjedh? Sa kam informata ai person punon edhe në arsim.Mos është në kundërshtim me ligjin?Nëse ka mundësi Drejtori i arsimit por ndoshta edhe s'ka përgjigje sepse ky nuk e paska pru këtë pikë por dikush tjetër.

**Kryesuesi** - në materialin që iu kemi dërgu e keni edhe vendimin për formimin e këshillit të prindërve në nivel komunal.

**Avni Bytyqi** - te çështja e përzgjedhjes nuk do të përzihem në temë për arsye se nuk kam qenë pjesë e përzgjedhjes së kryetarit të këshillit të prindërve në nivel Komune.Te çështja se a duhet të votohet dhe nga kush ka ardhë kërkesa,kërkesa ka ardhë pikërisht nga Drejtoria e Arsimit dhe ju e keni kërkesën para vete.A duhet të votohet dhe pse duhet të ndryshohet? Në bazë të udhëzimit administrative të MPL-së MPB të viti 2012 janë të përcaktuara sipas detyrës zyrtare se kush duhet të jetë pjesë KKS-së dhe njëri prej tyre është edhe kryetari i këshillit të prindërve në nivel të Komunës që me automatizëm shkon anëtar i KKS-së dhe kërkesa ka qenë nga DKA për arsye se Adem Dërguti që deri më tani është në kuadër të KKS,është zëvendësu sipas procedurave që ka udhëheq DKA,nëse ka udhëheq me Herolinda Berishën dhe ne jemi të obligum ta ndryshojmë vendimin për KKS-në dhe Herolinda Berisha nëse i plotëson kushtet apo kriteret sipas udhëzimit administrativ 01/2023,atëherë duhet të votohet,nëse jo atëherë mbetet të diskutohet çështja.

**Liridon Fandaj** - unë nuk po kuptoj.Drejtori po thotë: unë nuk e kam sjell.Kush e ka sjellë sepse duhet me ditë edhe ne.

**Kryesuesi** - lexon kërkesën e protokoluuar nga DKA.

**Liridon Fandaj** - pikat e rendit të ditës i bën ti Kryesues bashkë me Kryetarin.Atëherë,nëse një drejtor i juaji thotë që nuk e ka sjellë një pikë të rendit të ditës!

**Kryesuesi** - ndoshta i ka ik.Kjo është kërkesë zyrtare,e protokoluuar.

**Remzi Bajselamni** - ne si Drejtori e Arsimit e kemi pa të arsyeshme vetëm me njoftu Kryetarin e Komunës si Kryetar i KKS-së në Suharekë.Ndërsa procedurat se si është zgjedh kryetari i këshillit të prindërve janë zhvillu nën koordinim dhe monitorim të DKA-së që ka shku çdo gjë në rregull.Kur është zgjedh kryetarja aktuale kryetare e këshillit të prindërve,ka qenë krejt në rregull.Në gusht është zhvillu një procedurë,një konkurs në të cilën ka apliku dhe është pranë në gjimnaz profesorësh për psikologji dhe ka ra ndesh me ligjin.Ka pas me u ri rregullu dhe ka me u ri rregullu kryesia e këshillit të prindërve në K.Suharekës pastaj bëhet vendimin për anëtarësim në KKS,gjë që kujtoj që duhet me shku si anëtar i KKS-së kryetari i këshillit të prindërve pa emër.

**Liridon Fandaj** - në bazë të udhëzimit administrativ,anëtarët e KKS-së votohen në Asamble dhe nuk ka mundësi ti me bo veq një njoftim.Nëse ajo u zgjedh në gusht,ne me datë 20 gusht e kemi pas KPF-në dhe u dasht me tërhek dhe mos me sjell.

**Kryesuesi** - po e lexoj dhe një here kërkesën ku në fund të kërkesës thuhet: Andaj kërkoj nga ju që në vend të z. Adem Dërguti i cili ka qenë kryetar i këshillit të prindërve për Komunën e Suharekës, të vendoset znj. Herolinda Berisha kryetare.

**Liridon Fandaj** - ose duhet me tërheq këtë pikë ose, nëse e votoni, ju keni bërë shkelje të ligjit.

**Kryesuesi** - nëse jeni të pajtimit me tërheq, ne e tërheqim.

**Urim Suka** - kjo për mua është çështje teknike. Dilema e krejt kësaj është që gati as një procedure po duket që nuk është ndjek si duhet deri kur ka ardhë të kjo. Çështjet teknike krejt të vogla i ktheni në këso situata për shkak të një papërgjegjësie totale që e keni prej fillimit e deri në fund. Tash po zbulohet që edhe komunikimin ndër vete nuk e keni në nivelin e dëshiruar. Tëndeça e drejtorit për me i ik një përgjegjësi është e papërgjegjshme. Unë shqetësimet më të mëdhaja i kam te procedura nëse u ndjek si duhet. Kur të vje një material, duhet me na ardhë edhe procesverbali i asaj zgjedhje se si ka shku mënyra e zgjedhjes. Ju keni jo seriozitet edhe në çështjet tepër të vogla. Është mirë që sa ma shpejt ju me lënë këtë qeverisje, për të mirë të qytetarëve.

**Kryesuesi** - e hedhë në votim që pika 3 e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343 të datës 28.01.2022, të tërhiqet nga rendi i ditës.

### Unanimisht Miratohet

#### **Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 i datës 29.01.2021;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Flamur Bytyçi** - kërkoj një sqarim se pse nuk është nënshkruar? A ka dhënë arsye?

**Avni Bytyçi** - që nga viti 2014 e këndeje prona publike është dhënë sipas procedurave të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme. Gjatë dhënies në shfrytëzim të pronës publike afatgjatë, çdo herë komisioni dhe Kuvendi ka vendos që operatori i cili ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të pronës publike që ta sjell garancionin bankar prej 10% të vlerës së ofertuar në ofertën që ka ofertuar për ta marrë pronën publike në shfrytëzim. Përfituesi nuk ka qenë i gatshëm që ta sjell garancionin bankar dhe nuk e ka nënshkruar kontratën dhe ne jemi të detyruar që ta shfuqizojmë vendimin.

**Liridon Fandaj** - sa është afati për me lidh kontratë pasi që komisioni e shpall fitues të një prone? Pasi është një afat pesëmbëdhjetë ditor, u dasht me nënshkru. Nëse nuk u nënshkru, atëherë me prur atë vendim përnjëherë por jo me dëmtu Komunën 2 vjet. Nëse dikujt ia shkëputni kontratën për atë afatin e caktuar, cili është interesi që për një operator tjetër dy vjet mos me marrë vendim. Për këtë vendim dikush duhet të jap përgjegjësi. Nëse jo operatori, ai që e ka dëmtu Komunën që dy vjet.

**Avni Bytyçi** - është e vërtetë që ligji i parashih afatet por nëse e shihni edhe te vendimi, thotë që në afat prej 10 ditësh nga dita e miratimit dhe konfirmimit të ligjshmërisë së vendimit, operatori ekonomik është i obliguar ta sjell garancionin bankar. Operatori ekonomik nuk e ka sjell garancionin bankar dhe nuk ka pas mundësi Komuna me ekzekutu atë garancion bankar siq e potencove sepse s'ka pas. Kërkesën kur e kemi bërë si Komunë në emër të Kryetarit të Komunës, i kemi thënë që nëse në afatin e paraparë prej 10 ditësh nuk e sjell garancionin bankar konsiderohet që ke heq dorë nga e drejta e shfrytëzimit të pronës me vullnetin tend të lirë.

**Liridon Fandaj** - cilat janë veprimet që Kryetari i ka marrë për 10 ditë nëse ai nuk e ka sjell vendimin?

**Avni Bytyçi** - për këtë pjesën tjetër nuk kam përgjigje sepse nuk jam kompetent ndërsa për çështjen e afatit ligjor për garancion bankar, ta sqarova.

**Shefket Kolgeci** - a është kërkesë e operatorit për me heq dorë apo është vendim i Kuvendit Komunal pasi që nuk i ka kry obligimet operatori?

**Kryesuesi** - kjo është kërkesë e Komunës sepse siq e tha edhe zyrtari ligjor, ai e ka hup të drejtën.

**Liridon Fandaj** - kam një shqetësim prej qytetarëve që ndoshta mund të jetë edhe gabim por votat për buxhet nuk janë numru në rregull.

**Kryesuesi** - në rregull janë numru. E hedh në votim pikën 4 për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 i datës 29.01.2021;

**Pika 5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e ZKA-së;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Selman Kolgeci** - i kemi tri rekomandime që janë të përsëritur prej vitit të kaluar dhe dy pjesërisht të përsëritura. Kemi 5 rekomandime që përbëjnë një kopje të keqe të planit të veprimit që e keni prezantuar vitin e kaluar në këtë Kuvend. Keni thënë se keni me i marrë të njejtat veprime, veprime të cilat kanë rezultuar të pa suksesshme. Pse duhet me prit rezultat për veprimet e njejtat? Tek çështja 2.1 Mungesa e projekteve ekzekutive, e keni thënë se ky rekomandim do të zbatohet nga data 17.07.2023 deri më 31.12.2023 me arsyetimin sepse është në fazën e tenderimit ku ka me kontraktuar një kompani për hartimin e projekteve. Veprimet që jeni zotuar që do të ndërmerrni, nuk qëndrojnë dhe ky rekomandim nuk do të zbatohet sikurse gjetja do të vazhdojë të jetë aktive për faktin se sot jemi me datën 28 shtator dhe Komuna akoma nuk e ka kontraktuar kompaninë për hartimin e projekteve. Edhe nëse kompanitë ushtrojnë të drejtën e tyre të ankesës, kjo datë do të shtyhet dhe Komuna mund të mos hartojë asnjë projekt për investime kapitale për vitin 2023. E keni gabim me vazhdu me implementu investime kapitale pa hartim të projekteve. Jemi duke i pa pasojat çdo ditë dhe kemi me i pa edhe në të ardhmen. Keni thënë që keni mi ndërmarrë këto veprime për këto rekomandime deri më 31 dhjetor por besoj që është një gabim teknik por nëse nuk është gabim teknik ju kujtoj që këtë veprim duhet të vazhdoni ta ndërmerrni edhe më tutje. Tek çështja A2 Vonesa në realizimin e projekteve. Edhe te kjo çështje keni dhënë afate kohore se kur do të ndërmerrni veprimet që të eliminohen vonesat në kryerjen e punimeve. Pra, këtyre afateve nuk jeni duke iu përmbajtur. Tek çështja A3 Pagesa përmes vendimeve gjyqësore përmbartimore. Tek veprimet e ndërmarrura keni thënë se Komuna për personin i cili pritet të del në pension ka paraparë pagesa sipas kontratës kolektive të lidhur në mes të MASHT dhe Sindikatës së Arsimit. Me datë 21 dhjetor 2022 MASHT e ka shkëput kontratën kolektive me SBASHK-un. A ka mbështetje ligjore që të përdoret një marrëveshje e cila tashmë nuk është në fuqi për tu paguar zyrtarë që kanë me dalë në pension apo këtë veprim e keni shënuar veq me testu vigjilencën tone? Ju kontartën kolektive nuk e keni zbatuar kur ka qenë aktive dhe po tentoni tash kur është shkëput me respektu. Shqetësim mbetet zbatimi i këtij plani, me theks të veçantë se a do të zbatohen veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë sipas këtij plani. Unë e di që jo dhe për këtë i dhashë më lartë disa nga argumentet që ky plan veprimi në disa çështje nuk është i zbatueshëm e në disa çështje tjera nuk zbatohet.

**Flamur Bytyçi** - e kam analizu këtë plan veprimi dhe janë afërsisht 17 shkelje të evidentume. Këto nuk janë rekomandime por janë shkelje të ligjit. Sikur edhe e dime ne, që dy zyrtar publik janë në parburgim për shkak të shkeljeve të tilla, edhe pse këto shkelje ne disa here i kemi evidentuar, ju prap keni vazhdu me metodën e juaj dhe asnjëherë s'keni ndërmarrë veprim për përmirësim të gjendjes. Në shkruhen kontrata pa projekte, hartohen specifikime teknike pa analiza të gjendjes reale, në shkruhen kontrata ku askush nuk e din se çka po punohet. Si pasojë e këtyre shkeljeve që janë duke vazhduar çdo ditë, ka shumë procedura gjyqësore për zyrtarë të cilët nuk kanë kurrfarë përgjegjësie. Ditëve të fundit me sa kamë dëgju është ngritur aktakuzë edhe ndaj dy zyrtarëve tjerë. A mund të na siguron se kush i harton projektet, paramasat dhe ta dime kush është personi përgjegjës për këtë situatë? A keni pak dinjitet për drejtoritë tuaja që i udhëheqni?

**Urim Suka** - para se me diskutu për këtë pikë, e kam një shqetësim të cilin pak a shumë në disa koordinime që pata, e mora. Në votimin e buxhetit ka indikacione që numërimi për vota kur kanë votu asambleistët nuk është bërë siq duhet sipas vullnetit të asambleistave. Sipas informatave që kam, ka një gabim në numërim të votave. Nuk po du me menu që kjo ka ndodhur qëllimshëm por mbas koordinimeve që pata, rezultoi që 15 vota këtu janë deklaruar kundër. Inqizimet janë dhe mujna me u kthyer tani me i pa inqizimet ose mujna me hedh në votim risht. Kërkoj që ta rregullojmë këtë problem.

**Kryesuesi** - jemi te pika 5 dhe mund të vazhdojmë.

**Urim Suka** - në qoftëse është ky dyshim që unë po e ngriti, vërtetohet që është numru gabim dhe në qoftëse ti tash nuk e merr mundin me i kqyr ato kamera ose me hedhë në votim, i bie që ti e ke bërë me qëllim.



**Kryesuesi** - se kam bo me qëllim dhe ka qenë çdo gjë në rregull deri tash.Mund të vazhdojmë me pikën 5.

**Urim Suka** - nëse insiston,i bie që e ke bërë me qëllim.

**Kryesuesi** - jo nuk e kam bërë.Jeni dëshmitar që dy here i kam numëru.

**Urim Suka** - a i verifikojmë ato vota dhe vazhdojmë me seancën? përndryshe edhe ashtu ne kemi me e verifiku por nëse ti nuk e kthen kërkesën që unë kamë,kjo i bjen që ti e ke bërë me qëllim dhe përgjegjësia më e madhe është te ti.

**Kryesuesi** - nuk kamë përgjegjësi sepse jam këtu prezentë dhe dy herë i kam numëru votat.

**Urim Suka** - unë i kam informatat e bazune që janë 15 vota kundër.Është mirë të bëhet një pauzë dhe me i verifiku ato vota për me funksionu masanej.Kërkoj një pauze 10 minuta për me verifiku këtë gabim teknik që ka ndodhë.

**Kryesuesi** - vazhdojmë me pikën 5.

**Urim Suka** - hedhe në votim kërkesën,po kërkoj pauzë 10 minuta.

**Kryesuesi** - nese do të diskutosh për pikën 5 vazhdo.

**Urim Suka** - hedhe në votim kërkesën që sapo bëra.Kërkesën duhet me hedhë në votim përndryshe nuk ka kuptim me vazhdu.

**Liridon Fandaj** - kërkesat për një pikë të rendit të ditës i propozon asambleisti.

**Flamur Bytyçi** - nuk është problem sepse ka rrugë tjera ligjore dhe mundemi me i ndjek.

#### **Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;**

**Sheqerie Zyrapi** - 1.Si mund të bëhet një zgjidhje për parkingjet në banesat kolektive? 2.Ndërrimi i shtyllave elektrike në sheshin “Besim Ndreca” për rreth banesave por edhe në vende tjera ku janë të vjetra shumë dhe të dëmtuara; 3.Shenjëzimi i rrugëve në dalje,te rruga “Ali Pashë Tepelena” dhe në Studenqan rruga që tregon për Mamushë është e shenjëzuar nga fshatarët.

#### **Grupi parlamentar i LDK-së dhe grupi parlamentar i LVV-së lëshojnë mbledhjen.**

**Visar Kuçi** - sa i përket parkingjeve,jemi duke e hartu një rregullore dhe një tarif për parkingjet.Kemi me bërë zgjidhje shumë shpejt. Nëse është shtylla elektrike e KEDS,ka punë KEDS ndërsa nëse është shtyllë për ndriçim,si Komunë bëjmë zgjidhje.

**Sheqerie Zyrapi** - nuk e di kush merret me shtyllat por ato janë shumë të dëmtune.Duhet me bërë një zgjidhje Komuna dhe me i vendos shtyllat prej betoni dhe të jenë pak më të larta.Kur të bëhet një fatkeqësi atje, atëherë mos të intervenon askush.

**Visar Kuçi** - si banorë paraqitne si shqetësim te inspektoriati dhe nëse është aset i KEDS-it,KEDS e ka obligim me rregullu.Te shenjëzimi e kemi një kontratë që është në OSHP,mendojmë që javën tjetër nënshkruhet kontrata.Lënda është kthy dhe në moment që nënshkruhet kontrata to ti shenjëzojmë shenjat.

**Sheqerie Zyrapi** - te dalja e emërgjencës,a ka mundësi aty me u nda rruga vetëm për emërgjencë,pra ana e majtë.Mos të parkohet asnjë makinë aty sepse po krijohet problem i madhë.

**Visar Kuçi** - unë të premtoj që do ta paraqes si shqetësim.Ne e kemi një inspektor të komunikacionit dhe një zyrtar të urbanizimit,do të dalim në teren dhe do ta bëjmë zgjidhjen.

Takimi përfundoi: 11:15

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj